



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA –REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Në ceshtjen juridike të:

AC-I-14-0029

B.M. Prishtinë.

Paditësi/Ankuesi

kundër:

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. "Agim Ramadani" nr.23, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS) i përbërë nga Ilmi Bajrami, Gjyqtar Kryesues, Sabri Halili dhe Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtarë, duke vendosur sipas ankesës së paditësit të paraqitur kundër Aktvendimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, C-IV-13-1066 të datës 15 janar 2014, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 17 tetor 2019, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Ankesa e paditësit, refuzohet si e pabazuar.**
- 2. Vërtetohet, Aktvendimi i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, C-IV-13-1066 i datës 15 janar 2014.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe gjendja faktike

Me datë 1 korrik 2013, ankuesi dorëzoi në dhomën e posaçme një kërkesë/ankesë kundër vendimit të autoritetit të Likuidimit të AKP-së, PRN105-0013 të datës 06/06/2013 duke kërkuar nga gjykata që të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të detyroj AKP-në për kompensimin e pagave të papaguara në lartësi prej 900.00 Euro nga NSH "D" në Prishtinë. Ankuesi i ka bashkëngjitur ankesës një kopje të njoftimit të AKM-së për përfundimin e punësimit datë 17 nëntor 2006.

Me 27 shtator 2013, Dhoma e Posaçme ka kërkuar nga ankuesi të dorëzoj kopjen e vendimit të AKP-së kundër të cilit ka ushtruar ankesë, të caktoj një avokat për përfaqësimin e tij në procedurat para Dhomës së Posaçme sipas nenit 24.1 të shtojcës së Ligjit të Dhomës së Posaçme, pagesën e taksave gjyqësore në shumë prej 15 euro për parashtrim të ankesës, si dhe përkthimin në anglisht të ankesës dhe dokumenteve të bashkëngjitura me të.

Ankuesi ishte njoftuar me të drejtat e tij për të paraqitur kërkesë për ndihmë juridike dhe kërkesë për ndihmë në përkthim dhe për pasojat në rast të mos-përbushjes së urdhrit.

Me 30 tetor 2013, Dhoma e Posaçme përsëriti urdhrin te ankuesi dhe i njëjti ka pranuar urdhrin me 1 nëntor 2013 si dhe nuk ishte përgjigjur në mënyrë të plotë siç ishte urdhëruar . Në përgjigjen e tij të datës 1 nëntor 2013 ankuesi nuk dorëzoi kopjen e vendimit të AKP-së kundër të cilit ushtrohej ankesa.

Më datën 15 janar 2014 Kolegji i Specializuar kishte marrë Aktvendimin C-IV-13-1066 me të cilin ankesa kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së hedhet poshtë si e papranueshme. Me arsyetimin që ankuesi nuk ka arritur ta dorëzoj vendimin e AKP-së kundër të cilit ka ushtruar ankesë sipas urdhrit të gjykatës.

Me datën 4 shkurt 2014 paditësi ka parashtruar ankesë kundër këtij aktvendimi duke e kundërshtuar si të pabazuar për shkak të shkeljes së drejtës materiale dhe vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike.

Autoriteti i likuidimit duke vepruar sipas kërkesës sime për kompensim të pagave të papaguara ka konstatuar se Ankesa është hedhur poshtë si e papranueshme për shkak se nuk dorëzoi vendimin e AKP-së.

Me datën 16 qershor 2017 e paditura ka parashtruar, mbrojtje ndaj ankesës në të cilën ka pohuar se Autoriteti i Likuidimit ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike përcjellë nga zbatimi i saktë i dispozitave të zbatueshme ligjore. Po ashtu AKP-ja pohon se pretendimet e parashtruesit janë të parashkruara pasi që nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim juridik kundër NSH "D" gjatë periudhës 3 vjeçare të parashkrimit që fillon të llogaritet nga nëntori 2006.

Andaj propozon që ankesa të refuzohet si e pabazuar dhe të vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit.

Arsyetimi ligjor

Ankesa është e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 i Ligjit nr. 06/L-86 për DHPGJS-së Kolegji vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Kolegji i Apelit ka trajtuar me kujdes pretendimet ankimore të ankuesit, duke i krahasuar ato me arsyetimin e aktvendimit të kundërshtuar, por edhe me provat në shkresat e lëndës dhe gjeti se ankesa është e bazuar.

Në rastin aktual, ankesa e apeluesit ishte hedhur poshtë si e papranueshme sepse apeluesi nuk ka zbatuar urdhrin e Kolegjit të Specializuar për t`ia siguruar Aktvendimin e ankimuar të Komisionit të Likuidimit.

Kolegji i Apelit me kujdes e ka kontrolluar dosjen e lëndës dhe të gjitha kopjet e lëndës dhe parashtresat por nuk ka mundur ta vërtetojë se aktvendimi i kundërshtuar ishte paraqitur pas urdhrin të dytë të lëshuar nga gjyqtari i çështjes. Kolegji i Apelit gjen se urdhri i qartë i lëshuar sipas i Nenit 70.2 të shtojcës së Ligjit nr. 04/L-033 tani nenit 74.2 sipas Ligjit nr. 06/L-086 nuk mund të injorohet për këto arsye:

Së pari, duhet të kihet parasysh se procedurat në DHPGJS janë të rregulluara nga natyra si civile dhe si të tilla rregullohen nga parimi i disponueshmërisë së palës dhe përgjegjësisë së palës. Kjo do të thotë se fillimi apo ndërprerja e procedurave janë në duart e palëve dhe se ato kanë barrën e paraqitjes së provave dhe fakteve. Fakti se njëra palë është një agjenci publike e pavarur në asnjë mënyrë nuk nënkupton ndryshimin e natyrës civile të procedurës.

Së dyti, shqyrtimi i vendimeve të likuidimit rregullohet me Nenin 70 të Aneksit. Paragrafi 2 i kësaj dispozite urdhëron zbatimin e Nenit 27.2 të Aneksit dhe bashkëngjijtjen (sigurimin) e vendimit të kundërshtuar. Kriteri i pranueshmërisë së padisë dhe ankesave dhe pasojat e mos përmbushjes së këtyre kriterëve cekën në Nenin 28 të Shtojcës së Ligjit 04/L-033 tani sipas Ligji 06/L-086 neni 36. Kjo pasojë e mos përmbushjes së kriterit është pa përjashtim papranueshmëria (shih Nenin 36.3). Sipas Nenit 36.3, Gjyqtari/Kolegji nuk mund ta hedh poshtë një padi/ankesë të papranueshme para se ta lëshojë një urdhër me të cilin saktësohet afati kohor brenda të cilit paditësi/parashtruesi mund të korrigojë gabimet dhe ta parashtrojë kërkesën/ankesën. Nëse paditësi/parashtruesi nuk i korrigjon me kohë gabimet nga urdhri, kërkesa/ankesa mbetet e papranueshme dhe do të hidhet poshtë si e papranueshme. Rasti në fjalë është i tillë Gjyqtari ka lëshua dy urdhra me kërkesë të njëjtë.

Së treti, ratio legis i Nenit 70.2 tani 74.2 është që ti mundësoi, Kolegjit të Specializuar shqyrtimin e kriterit të pranueshmërisë së një kërkesë/ankese ndaj një vendimi të Autoritetit të Likuidimit pa hyrë në procedura të tjera në këtë fazë. Ky vlerësim është i mundur vetëm nëse gjyqtari/Kolegji i Specializuar e ka vendimin e kundërshtuar në dorë. Vetëm për këtë arsye, dispozita nuk është vetëm një barrë procedurale e pakuptimtë. Në vazhdim, mund të supozohet me siguri të plotë se parashtresit janë në posedim të vendimit që ata vendosin ta kundërshtojnë. Prandaj, nuk është barrë për parashtresin t`ia sigurojë DHPGJS vendimin e kundërshtuar. DHPGJS nga ana tjetër nuk ka qasje në vendim dhe të njëjtin duhet ta kërkojë nga AL i AKP-së e që paraqet edhe një barrë shtesë për DHPGJS-në. Argumenti që AKP është një Agjenci publike dhe si e tillë e obliguar t`ia sigurojë

dokumentacionin pasi ti kërkohet nuk është një argument mbështetës në kontekstin në fjalë.

Pakujdesia e ankuesit nuk duhet të rezultojë me ngarkesën e gjykatës dhe të paditurës dhe që ata ta kompensojnë pakujdesinë e tij.

Duhet theksuar se ankuesi ishte njoftuar shumë qartë se mos paraqitja e vendimit të kundërshtuar ishte arsye për hedhjen poshtë. Megjithatë, në ankesën e tij ai nuk ofron asnjë provë apo të paktën një provë rrethanore për pretendimin e tij se e kishte paraqitur aktvendimin në fjalë.

Andaj duke u bazuar në atë që u tha më lartë, dhe konform nenit 9.10 të LDHPGJS-së, Kolegji i Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Taksat Gjyqësore

Ankuesi nuk ngarkohet me taksë gjyqësore. Sipas nenit 13.3 ë Udhëzimit Administrativ nr. 01/2017, padit e punëtoreve për paga të pa paguara nen 1.000 euro lirohen nga pagesa e takse gjyqësore.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 17 tetor 2019.

Ilmi Bajrami Kryesuesi i Kolegjit të Apelit _____

URDHËR PËR ZYRËN E REGJISTRIMIT:

Ju lutem dërgojeni këtë Aktvendim tek:

- Palët,
- Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së në lëndën C-III-13-1066

Ilmi Bajrami, Gjyqtar Kryesues
